



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 9978 prot.

Vlorë, më 23.07 2023

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____, Datë, _____ 2023

**“MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË
KRYESISË DHE KRYATARIT TË FSHATRAVE NË JURIDIKSIONIN E
BASHKISË VLORË”**

Bazuar ne ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 70, në Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e strukturës komunitare në fshat” neni 4 , si dhe në Relacionin e paraqitur nga Administrata e Këshillit, Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e datës _____.

VENDOSI:

1. Të përcaktojë kriteret specifike që duhet të plotësojnë kandidatët për tu zgjedhur anëtarë të kryesisë dhe kryatër të fshatrave në juridiksionin e Bashkisë Vlorë si më poshtë:
 - a. Të jetë me banim në fshat
 - b. Kryetari Fshatit si rregull duhet të ketë minimumi arsim të mesëm
 - c. Të mos ketë qënë i dënuar me vendim të formës prerë nga gjykata
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryesia e Këshillit, si dhe këshilltarët e përcaktuar për ndjekjen e procedurës së zgjedhjeve sipas fshatrave.
3. Ky vendim hyn në fuqi bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 55 pika 6.

KRYETARE

Elpiniqi Merkuri

Konceptoi: *D.Zeraj*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr 9978 Prot

Vlorë, më 23 . 2023

RELACION

Mbi projektvendimin “Për përcaktimin e kriterëve për zgjedhjen e anëtarëve të kryesisë dhe kryetarit të fshatrave në juridiksionin e Bashkisë Vlorë “

Para Këshillit të Bashkisë.

Të nderuar këshilltarë !

Projektvendimi “Për përcaktimin e kriterëve për zgjedhjen e Anëtarëve të Kryesisë dhe Kryetarit të Fshatit në juridiksionin e Bashkisë Vlorë “, që ju propozojmë për miratim , është bazuar kryesisht në Ligjin Nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”si, dhe në Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e strukturës komunitare në fshat”, të miratuar nga këshilli i bashkisë . Nëpërmjet këtij projektvendimi, synojmë të vendosim disa kriterë specifike për zgjedhjen e anëtarëve të kryesisë si dhe të kryetarit të fshatit.

Konkretisht si kriter i parë , duhet të jetë domosdoshmëri që të jetë me banim në fshat çdo person që pretendon të zgjidhet në kryesinë e fshatit dhe, për rrjedhojë edhe kryetar i fshatit.

Gjithashtu për të evituar problematika në mardhëniet me komunitetin, vlerësojmë se, vendosja e kriterit të pastërtisë së figurës së personit të zgjedhur në kryesinë e fshatit, bën të domosdoshme të plotësohet kriteri që, të mos ketë qenë i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës.

Në Rregulloren “Për Organizimin dhe Funksionimin e Strukturës Komunitare në Fshat “ është parashikuar që kryetari i fshatit të ketë minimalisht arsimin e mesëm.

Vlerësojmë që ky kriter si rregull, të plotësohet nga personat që do të zgjidhen në kryesinë e fshatit.

Pavarësisht sa më lartë, nëse këshilli mendon se, duhet parashikuar ndonjë kriter tjetër shtesë , kjo mbetet për tu vlerësuar rast pas rasti.

Përfundimisht, kërkojmë nga këshilli që të miratojë këtë projektvendim, me qëllim që, të rritet cilësia e përfaqësimit në strukturat komunitare në fshat. Kjo dhe për faktin se, roli i kryesisë dhe kryetari i fshatit ka rëndësi për zgjidhjen e problematikave në fshat, por edhe si strukturë ndërlidhëse midis banorëve të fshatrave respektive me kryetarin dhe administratën e bashkisë si dhe me këshillin e bashkisë.

Konceptoi: D.Zëraj

KRYETARE
Elpiniqi Mërkuri

